



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 8 nëntor 2021  
Nr. ref.:RK 1884/21

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI118/20**

Parashtrues

**Selim Leka**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë  
së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev.179/19,  
të 14 janarit 2020**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Selim Leka nga Gjilani (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev.179/19, të 14 janarit 2020 në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac.nr.5550/18, të 20 shkurtit 2019 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.378/18, të 3 dhjetorit 2018.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë mohuar paga jubilarë dhe paga përcjellëse pas pensionimit.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura para Gjykatës**

5. Më 24 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës përmes postës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 3 gusht 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 12 gusht 2020, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës dhe nga ai u kërkuar që në Gjykatë të dorëzon formularin e kërkesës si dhe të specifikojë aktin konkret të autoritet publik që e konteston dhe të cekë saktësisht se cilat liri dhe të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë cenuar.
8. Më 25 gusht 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente që ndërlidheshin me kërkesën e tij të mëparshme të regjistruar në Gjykatë me nr. KI137/18.
9. Më 5 janar 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë që përbëjnë objektin e çështjes të kërkesës KI118/20, përfshirë: (i) Aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev.179/19, të 14 janarit 2020; (ii) Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac.nr.5550/18, të 20 shkurtit 2019 dhe (iii) Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.378/18, të 3 dhjetorit 2018.
10. Më 22 janar 2021, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
11. Më 22 janar 2021, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Themelore në Gjilan dhe po ashtu iu kërkuar që ta dorëzojë fletëkthesën që dëshmon se kur e ka

pranuar parashtruesi i kërkesës Aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev.179/19, të 14 janarit 2020.

12. Më 10 shkurt 2021, Gjykata Themelore në Gjiilan dorëzoi dokumentin e lartpërmendur në Gjykatë. Bazuar në fletë-kthesën e dorëzuar nga Gjykata Themelore në Gjiilan rezulton se Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev.179/19 i 14 janarit 2020 është pranuar nga parashtruesi i kërkesës më 1 gusht 2020.
13. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
14. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
16. Më 21 tetor 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhje e fakteve**

17. Parashtruesi i kërkesës paraqitet para Gjykatës për herë të dytë. Herën e parë, parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [Rev.nr.32/2018] të 27 shkurtit 2018. Ajo kërkesë ishte regjistruar me nr. KI137/18. Në atë rast, Gjykata kishte shpallur kërkesën të papranueshme për shkak të mos respektimit të afatit ligjor katër (4) mujor siç parashikohet me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës. Në rastin e tanishëm kontestohen vendime të ndryshme nga rasti KI137/18, mirëpo objekti i kërkesës është i njëjtë përkatësisht pretendimi i parashtruesit të kërkesës për kompensim të pagesës së një page mujore për shpërbllim jubilar dhe pagesën e një page mujore për përcjellje në pension dhe regresin.
18. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ishte pensionuar më 3 shkurt 2014 për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare të pensionimit. Ai kishte punuar mësimdhënës në shkollën fillore të mesme të ulët në Zabel, komuna e Gjiilanit.

19. Më 12 prill 2018, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, duke kërkuar të detyrohet e paditura që t'ia kompensojë pagesën e një page mujore për shpërbtim jubilar dhe pagesën e një page mujore për përcjellje në pension dhe regresin.
20. Më 3 dhjetor 2018, Gjykata Themelore në Gjilan me Aktgjykim [C.nr.378/18] e refuzoi të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës me të cilën kishte kërkuar që të obligohet e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan që parashtruesit t'ia paguaj një (1) pagë mujore për shpërbtim jubilar në shumën prej 365.33€, një (1) pagë mujore për përcjellje në pension në shumë prej 365.33€ si dhe regresin në shumë prej 120.00€, të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 850.66€, me kamatë ligjore prej 3.2% ashtu siç i paguajnë bankat në Kosovë, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
21. Gjykata Themelore arsyetoi: (i) kërkesëpadija e parashtruesit të kërkesës është e pabazuar sepse parashtruesi i kërkesës kërkesëpadinë e tij e bazon në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës që ka hyr në fuqi në janar të vitit 2005 dhe është zgjidhur sipas urdhrit të ligjit në janar të vitit 2008; (ii) ndërsa e njëjta kontratë nuk ka qenë në fuqi në kohën kur parashtruesi i kërkesës ka shkuar në pension më 10 shkurt 2014, fakt që vërtetohet me aktvendimin me numër të protokollit numër 05-061-13151/2014 të 10 shkurtit 2014; (iii) dhe nga këto arsye e njëjta kontratë nuk mund të krijojë të drejta dhe detyrime për parashtruesin e kërkesës e as detyrime për të paditurën; (iv) po ashtu as Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e cila ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2015 nuk paraqet bazë ligjore për kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për arsye se në këtë Marrëveshje nuk ka ndonjë dispozitë që e parashih se e njëjta mund të aplikohet edhe për personat që janë pensionuar para vitit 2015.
22. Më 20 shkurt 2019, Gjykata e Apelit me Aktvendim [AC.nr.5550/18] vendosi: (i) Priset Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, C.nr.378/18 të 3 dhjetorit 2018; dhe, (ii) Hedhet poshtë padia e parashtruesit të kërkesës.
23. Gjykata e Apelit konstatoi: (i) ndërmjet palëve ndërgjyqëse është gjykuar më herët procedura kontestimore me palë të njëjta dhe objekt kontesti të njëjtë; (ii) Gjykata Themelore në Gjilan me Aktgjykim [C.nr.298/14] të 23 majit 2016, ka vendosur në mënyrë meritore dhe ka refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës të pabazuar ndaj të paditurës me objekt kontesti të njëjtë; (iii) Gjykata e Apelit me Aktgjykim [Ac.nr.3137/16] të 26 tetorit 2017 e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës themelore; (iv) ndërsa Gjykata Supreme me Aktvendim [Rev.nr.32/2018] të 27 shkurtit 2018 e ka hedhë të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës. Gjykata e Apelit përfundoi se në këtë çështje kemi të bëjmë me çështje të gjykuar *res iudicata*, prandaj vendosi si në dispozitiv të Aktvendimit e bazuar në nenin 198.1 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore që, mes tjerash, parashikon: "*Në qoftë se gjykata e shkallës së dytë konstaton se në gjykatën e shkallës së parë është vendosur mbi kërkesën...për të cilën ekziston aktgjykimi i formës së prerë...atëherë ajo e prishë aktgjykimin e shkallës së parë dhe e hedhë poshtë padinë*".

24. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të lartpërmendura të gjykatave të instancës më të ulët.
25. Më 14 janar 2020, Gjykata Supreme me Aktvendim [Rev. 179/19] e hodhi të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër vendimeve të gjykatave të instancës më të ulët.
26. Gjykata Supreme konstatoi: (i) parashtruesi i kërkesës ka paraqitur revizion të cilin e ka emëruar si ankesë, pa e theksuar bazën e kontestit, por me propozim që vendimet e gjykatave të instancës më të ulët të anulohen dhe çështja të kthehet për rivendosje në gjykatën e shkallës së parë;(ii) neni 211.2 i LPK-së parashikon se revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike, në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, nëse vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000€; (iii) në rastin konkret bëhet fjalë për kërkesëpadinë ku është përcaktuar vlera prej 850.66€, prandaj, revizioni në këtë rast nuk lejohet dhe konsiderohet i palejuar.
27. Gjykata Supreme po ashtu shtoi: *“Duke pasur parasysh se gjykata e shkallës së parë në procedurën paraprake të shqyrtimit të lejueshmërisë së revizionit, është dashtë ta hedhë poshtë, kjo Gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.”*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

28. Parashtruesi i kërkesës nuk përmend nëse në dëm të tij është cenuar ndonjë dispozitë kushtetuese në veçanti. Ai kërkon *“që të kompensohet për një (1) pagë mujore për shpërblim jubilar në shumën prej 365.33€, një (1) pagë mujore për përcjellje në pension në shumë prej 365.33€ si dhe regresin në shumë prej 120.00€, të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 850.66€, me kamatë ligjore prej 3.2% ashtu siç i paguajnë bankat në Kosovë”*.
29. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës *“Ju si Gjykatë Kushtetuese, organi më i lartë juridik, vlerësoni në mënyrë të drejtë lëndën dhe mos diskriminoni punëtorin e arsimit pas pensionimit.”*
30. Lidhur me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës shprehet: *“Si është e mundur një Gjykatë të jap dy mendime: prishet dhe refuzohet, nuk shkruhen në asnjë dokument në drejtësi.”*
31. Parashtruesi i kërkesës kërkon: (i) të aprovohet në tërësi kërkesëpadia për pagat pas pensionimit kundër palës së paditur Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan dhe (ii) ose lënda të kthehet në rivendosje *“siç ka vendosur Gjykata e Apelit.”*

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

32. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

34. Gjykata i referohet nenit 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit, që parashikon:

Neni 47  
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

35. Gjykata po ashtu i referohet nenit 49 (Afatet) të Ligjit në lidhje me rregullin 39 (1) c) [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që parashikojnë:

Neni 49  
(Afatet)

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”*

Rregulli 39 i Rregullores së punës  
[Kriteret e pranueshmërisë]

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*  
[...]

*c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe*  
[...]

36. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev.179/19] të 14 janarit 2020, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj.

37. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit. Mirëpo, parashtruesi i kërkesës kërkon (i) të aprovohet në tërësi kërkesëpapia për pagat pas pensionimit kundër palës së paditur Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan dhe (ii) ose lënda të kthehet në rivendosje “siç ka vendosur Gjykata e Apelit.”
38. Gjykata vlerëson se në rrethanat e rastit konkret, si çështje paraprake, duhet të vlerësojë: (i) nëse kërkesa e tanishme është dorëzuar brenda afatit ligjor katër (4) mujor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe (ii) cili është “vendimi i fundit” në kuptim të nenit 113 (7) të Kushtetutës në ndërlidhje me rrjedhjen e afatit ligjor katër (4) mujor nga neni 49 i Ligjit.
39. Nga dokumentet shtesë të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës më 5 janar 2021, Gjykata vëren se vendimet që shprehimisht janë kontestuar nga parashtruesi i kërkesës janë: (i) Aktvendimi i Gjykatës Supreme [Rev.nr.179/19] 14 janarit 2020; (ii) Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ac.nr.5550/18] i 20 shkurtit 2019; dhe (iii) Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan [C.nr.378/18] i 3 dhjetorit 2018.
40. Nga sa më sipër, Gjykata rikujton se afati katër (4) mujor fillon nga “vendimi i fundit” në procesin e shterjes së mjeteve juridike me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtruesit (shih rastet e Gjykatës nr. KI112/19 *Parashtrues Ilir Kabashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 37; nr. KI120/17 *Parashtrues Hafiz Rizahu*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 30).
41. Gjykata rikujton po ashtu se parashtruesi i kërkesës duhet t’i shterojë të gjitha mjetet juridike të cilat pritet të jenë efektive dhe të mjaftueshme. Vetëm mjetet efektive juridike mund të merren parasysh nga Gjykata, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk mund të zgjasë afatet e detyrueshme të parashikuara me Ligj dhe me Rregullore të punës, duke u përpjekur që të shterojë mjetet juridike që nuk janë të lejuara ose duke u ankuar në institucionet që nuk kanë kompetencë që të ofrojnë mbrojtje të të drejtave për të cilat ankohet parashtruesi i kërkesës (shih rastet e Gjykatës KI112/19, *Parashtrues Ilir Kabashi*, cituar më lart, paragrafi 38; KI120/17, *Parashtrues Hafiz Rizahu*, cituar më lart, paragrafi 31, si dhe rastin e GJEDNJ-së *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Vendim për Pranueshmëri i 5 janarit 2006).
42. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Aktvendimit të Gjykatës Supreme [Rev.nr.179/19] të 14 janarit 2020, që përcakton: (i) parashtruesi i kërkesës ka paraqitur revizion të cilin e ka emëruar si ankesë, pa e theksuar bazën e kontestit, por me propozim që vendimet e gjykatave të instancës më të ulët të anulohen dhe çështja të kthehet për rivendosje në gjykatën e shkallës së parë; (ii) neni 211.2 i LPK-së parashikon se revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike, në të cilat kërkesëpapia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, nëse vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000€; (iii) në rastin konkret

bëhet fjalë për kërkesëpadinë ku është përcaktuar vlera prej 850.66€, prandaj, revizioni në këtë rast nuk lejohet dhe konsiderohet i palejuar.

43. Gjykata po ashtu i referohet nenit 228.1 [Revizioni kundër aktvendimit] të Ligjit të Procedurës Kontestimore, që parashikon:

*“Neni 228  
[Revizioni kundër aktvendimit]*

*1. Palët mund të paraqesin revizion vetëm kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë [...]*

44. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pas pranimit të Aktvendimit Gjykatës së Apelit [Ac.nr.5550/18] të 20 shkurtit 2019, ka mundur që të dorëzon kërkesë në Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës ka përdorur mjet të jashtëzakonshëm juridik që në rastin e tij ka rezultuar mjet i palejuar me ligj dh i pa efektshëm për shkak se nuk i ka plotësuar kushtet e paparapara me nenin 211.2 të LPK-së, përkatësisht vlera e objektit të kontestit nuk ka kaluar shumë prej 3.000 €.
45. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se Aktvendimi i Gjykatës Supreme [Rev.nr.179/19] i 14 janarit 2020, në rastin e parashtruesit të kërkesës, është mjet jo efektiv juridik që nuk ka pasur nevojë të shterohet, dhe rrjedhimisht, nuk mund të jetë objekt i vlerësimit kushtetues.
46. Gjykata vlerëson se “vendim i fundit” bazuar në nenin 49 të Ligjit është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ac.nr.5550/18] i 20 shkurtit 2019, me të cilin ishte hedhur poshtë ankesa e parashtruesit të kërkesës dhe i cili ishte i formës së prerë dhe i paapelueshëm (shih rastin e Gjykatës KI112/19, *Parashtrues Ilir Kabashi*, cituar më lart, paragrafi 43).
47. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej katër (4) muajsh, bazuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështjet kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe të parandalohet mbajtja në gjendje pasigurie për një periudhë të gjatë e palëve dhe personave tjerë të përfshirë proces gjyqësor (shih *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së *Parashtrues Sabri Güneş*, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafi 40 dhe referencat e përmendura aty; dhe Rastin e Gjykatës Kushtetuese *Parashtrues Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 marsit 2014, paragrafi 24).
48. Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac.nr.5550/18] të 20 shkurtit 2019 është dorëzuar pas afatit ligjor katër (4) mujor të parashikuar me nenin 49 të Ligjit dhe specifikuar më tej me Rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.
49. Nga sa më sipër, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të refuzohet e paafatshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) c) të Rregullores së punës.



## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (1) c) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 21 tetor 2021, njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues

  
Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Gresa Caka-Nimani